

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 573 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 35, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Kisha Paleokristiane në Sukën e Gjelit-Lezhë"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha (IA),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim " Kisha Paleokristiane në Sukën e Gjelit, Lezhë "*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Gëzim Hoxha (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmime me qëllim sqarimin e planimetrisë së absidës dhe sanktuarit; sqarimin e ekzonarteksit; sqarimin e stratigrafisë së kishës.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë 25 Korrik - 10 Gusht 2016
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet nga IA pranë IMK, dokumentacioni i nevojshëm për shpalljen e Kishës Paleokristiane në Sukën e Gjelit-Lezhë, monument në mbrojtje paraprake, e më pas të vijojë procedura, për shpalljen e saj monument kulture.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al